



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 3  
25.01.2012

NR. VENDIMI 1  
28.01.2012

**VENDIM**  
**“Në emër të Republikës”**

Gjykata e Shkallës së Parë  
për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej:

**Gjyqtare : Iliriana OLLDASHI**

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Ermira Tërbuni**, sot në datën **28/01/2012, ora 11.00 në Tiranë**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale **nr. 3** që i përket :

**Kërkues:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokurori **B. M. .**

**Me objekt:** Sekuestrimin e pasurive.

**KUNDËR:**

**1- Shtetasit nën hetim M. Ç. ,** i biri i M. dhe i H. , i dtl. xx/xx/xxxx, lindur në xxxxxxxxxx dhe banues në xxxxxxx, Rruga « xxxxxxx I xxxxxxx ».

**2. Personi Juridik**

« K. » sh.p.k., me ortak të vetëm dhe administrator të vetëm shtetasin M. Ç. , me adresë Rruga « xxxxxxx xxxxx », xxxx nr. x.

**BAZA LIGJORE:**

**Ligji nr. 10192 datë 03/12/2009** «Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet

## Masave Parandaluese kundër Pasurisë».

**Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës të zhvilluar në prani të prokurorit B. M. që kërkoi: pranimin e kërkesës, kjo gjykatë pasi dëgjoji kërkimet dhe shqyrtoi aktet e paraqitura :**

### **VËREN se :**

Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka paraqitur para kësaj gjykate një kërkesë për sekuestrimin e pasurive të shtetasit M. Ç. dhe Personit Juridik « K. » sh.p.k. duke pretenduar se janë subjekte të hetimit pasuror sipas ligjit **nr.10192 datë 03.12.2009** «Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë» dhe pasuritë e zotëruara nuk i përgjigjen nivelit të të ardhurave dhe fitimeve të tyre, si dhe ekziston rreziku, që këto pasuri të humbasin, apo tjetërsohen. Kërkesën prokurori e paraqet duke ju këtyre fakteve:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të materialit të ardhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ka regjistruar procedimin pasuror nr. 1 datë 06/01/2012 në ngarkim të shtetasit M. Ç. dhe personit juridik « K. » sh.p.k.

Kjo Prokurori ka regjistruar procedimi penal nr. 82, datë 28/02/2011, në kuadër të të cilit ka marrë të pandehur shtetasin M. Ç. për veprat penale të « Mashtrimit » dhe « Pastrimit të produkteve të veprës penale », parashikuar nga nenet 143/2 dhe 287 të Kodit Penal dhe Personin Juridik « K. » sh.p.k. me ortak të vetëm dhe administrator të pandehurin M. Ç. , për veprat penale të « Mashtrimit » dhe « Pastrimit të produkteve të veprës penale », parashikuar nga nenet 143/2 dhe 287 të Kodit Penal.

Nga hetimet ka rezultuar se i pandehuri M. Ç. në datën 06/02/2008 ka krijuar shoqërinë « K. » sh.p.k. me objekt ligjor botime shtypi, përhapje e lajmit dhe e promocionit , konsulencë juridike etj., me seli në disa qytete të Shqipërisë përfshi qytetin e Beratit. I pandehuri M. Ç. në marrëdhënie me të tretët është prezantuar si përfaqësuesi ligjor i shoqërisë dhe Drejtor i Përgjithshëm i saj. Shtetasi R. B. ka punuar si drejtor rajonal i shoqërisë për Beratit dhe shtetasja A. Dh. si zëvendës drejtore e përgjithshme dhe ekonomiste.

I pandehuri M. Ç. në marrëdhënie me persona të tjerë pretendonte, duke gënjer, se shoqëria e tij financiohej nga USAID. Ndërsa nga hetimet në asnjë moment nuk është konstatuar që kjo shoqëri tregtare të ketë pasur marrëdhënie me USAID-in. Kjo gënjeshtër përdorej me qëllim për të rritur besimin dhe vjedhur klientët. Ky shtetas në mënyrë të përsëritur në

bashkëpunim dhe me shtetasit e përmendur më sipër u ka marrë shtetasve të ndryshëm në disa qytete të Shqipërisë sasinë prej 100.000 lekësh ose shuma të tjera më të mëdha, duke u premtuar punësim dhe trajnime në fushën e gazetarisë, apo duke u premtuar shërbime të tjera si asistencë juridike, ndërmjetësim tek funksionarë shtetërorë, si tek prokurorë, gjyqtarë, punonjës të Presidencës, këshilltarë për lirimin e personave të dënuar me burgim, duke i gënjyer në këtë mënyrë që t'i jepnin shumat e të hollave, me qëllim përvetësimin e tyre.

Këto përfitime ky shtetas herë i ka marrë në mënyrë të drejpërsëdrejtë dhe herë nëpërmjet llogarisë së tij në Raiffeisen Bank. Një pjesë të këtyre përfitimeve të paligjshme i pandehuri M. Ç. i ka depozituar në llogarinë bankare të shoqërisë « K. » sh.p.k. duke i investuar, si para produkte të veprës penale të « Mashtrimit », në veprimtaritë ekonomike dhe financiare të shoqërisë. Këto të holla i pandehuri i ka reklamuar si fitime të ligjshme të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë « K. » sh.p.k. Në këtë kuadër ai ka paguar punonjësit e shoqërisë, ka likujduar detyrime ndaj personave të tretë si dhe ka blerë katër automjetet në emër të shoqërisë dhe pjesën më të madhe e ka tërhequr personalisht nga banka. Këto veprime janë kryer më shumë se një herë duke sjellë si pasojë pastrimin e një shume prej më tepër se 10 000 000 lekësh.

Shtetasi M. Ç. dhe shoqëria « K. » sh.p.k. kanë në pronësi mjetet me targa **xx xxxx x, xx xxxx x, xx xxxx x dhe xx xxxx x**. Gjithashtu nga aktet e hetimit rezulton se shoqëria « K. » sh.p.k. ka dy llogari bankare në Raiffeisen Bank njëra në lekë dhe tjetra në Euro. **Llogaria bankare në euro ka një shumë të papërfillshme ndërsa ajo në lekë me nr. xxxxxxxxxx në datën 05/04/2011 ka gjendje 47,112.17 lekë.**

Nga veprimet hetimore ka rezultuar se i pandehuri M. Ç. nuk rezulton që të ketë të ardhura të tjera nga burime të ligjshme dhe sipas akteve të hetimit rezulton se këto mjete janë blerë me mjetet financiare të vjedhura nëpërmjet mashtrimit. Gjithashtu sipas përgjigjeve të ardhura nga organet tatimore rezulton se shoqëria « K. » sh.p.k. është krijuar në datën 13/12/2007 dhe paraqitet si mosdeklarues para këtyre organeve prej majit 2008, duke mos pasur kështu asnjë fitim apo të ardhur të ligjshme.

**Gjykata vlerëson si të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesen e Prokurorisë për Krime të Rënda, e cila duhet të pranohet duke vendosur sekuestrimin e pasurive të shtetasit M. Ç. dhe personit juridik “K.” sh.p.k sepse:**

Shtetasi shqiptar M. Ç. dhe personi juridik «K.» sh.p.k dyshohen dhe hetohen për veprat penale të parashikuara nga nenet 143/2 dhe 287/2 të Kodit Penal.

Pra nisur nga lloji i veprës për të cilën hetohen « Pastrimi i produkteve të veprës penale » dhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar tek indicjet se shtetasi M. Ç. dhe personi juridik «K.» sh.p.k janë të përfshirë në një veprimtari kriminale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe janë subjekte ndaj pasurive të të cilëve zbatohen dispozitat e ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009** “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”, sipas parashikimit **te nenit 3/1 pika ç** e këtij ligji.

Mbi këtë bazë, rezulton se akuza ka rregjistruar edhe procedimin pasuror nr. 1 në datën 06/01/2012, ndaj këtyre subjekteve dhe pasi është kryer hetimi pasuror kjo çështje është paraqitur para kësaj gjykate me kërkesën për sekuestrimin e pasurive që janë verifikuar nga akuza se janë në pronësi të shtetasit M. Ç. dhe personit juridik «K.» sh.p.k.

Nga hetimi pasuror i kryer nga policia gjyqësore, sipas parashikimit të nenit 6 të ligjit nr.10192, akuza pretendon se si rrjedhojë e veprimtarisë kriminale, shtetasi M. Ç. dhe shoqëria « K. » sh.p.k. kanë në pronësi mjetet me targa **xx xxxx x, xx xxxx x, xx xxxx x dhe xx xxxx x** dhe se shoqëria « K. » sh.p.k. ka dy llogari bankare në Raiffeisen Bank njëra në lekë dhe tjetra në Euro. Llogaria bankarë në euro ka një shumë të papërfillshme ndërsa ajo në lekë me nr. xxxxxxxxxxxx **në datën 05/04/2011 ka gjendje 47,112.17 lekë**, pasuri që **haptazi nuk përputhen me të ardhurat ekonomike të verifikuara nga akuza se ka siguruar shtetasi M. Ç. dhe shoqëria « K. » sh.p.k.**

Pra në bazë të provave të paraqitura nga akuza, gjykata vlerëson se **shtetasi M. Ç. dhe shoqëria « K. » sh.p.k.** janë subjekte të ligjit nr. 10192 datë 03/12/2009 “**Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë**” sepse jo vetëm që ka dyshime të arsyeshme të bazuar në indicje se ata kanë kryer një nga veprat penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr.10192, por edhe sepse i janë evidentuar nën posedim pasuri dhe vlera monetare, të cilat nuk justifikohen dukshëm me të ardhurat e tyre.

Gjykata mbi bazën e provave të shqyrtuara vlerëson se ekziston një rrezik real për humbjen e pasurive që kekohet të sekuestrohen, rrethanë, kjo e parashikuar nga neni **11/1 pika a** e ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009**, prandaj me qëllim ruajtjen e saj, është e nevojshme vendosja e masës së sekuestrimit.

Meqënëse sipas nenit 12 të ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009**, ky gjykim u zhvillua vetëm me praninë e prokurorit, urdhërohet sekretaria gjyqësore të njoftojë shtetasin M. Ç. dhe shoqërinë « K. » sh.p.k., në emër të

së cilëve rezultojnë pasuritë që sekuestrohen sipas neneve 130 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, në adresat e vendndodhjes dhe të qendrës së tyre.

Për ekzekutimin e këtij vendimi, në përputhje me nenin 14 të ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009** urdhërohet Zyra e Përmbartimit Gjyqësor Tiranë dhe Vlorë, ndërsa për administrimin dhe përdorimin pasurive ngarkohet **z. K. Xh. ,i** cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Mbi arsyetimin e pasqyruar më sipër në bazë të nenit 212 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 3/1/d, 3/2/a, 3/4 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009** “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Njepërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, kjo gjykatë pasi formoi bindjen dhe në mbështetje të provave të shqyrtuara në këtë gjykim:

## **V E N D O S I**

- Pranimin e kërkesës duke sekuestruar pasuritë e mëposhtme: \_ \_
  - a- Mjetin e markës Mitsubishi, lloji foristradë, tipi xxxxxxx xxxxx, me nr. Shasie XXXXXX XXXXXXXXXXXX, me xxxxx, ngjyra xxx me traga **XXXXXX .**
  - b- Mjetin e markës Benz, lloji autoveturë, tipi xxxx xxx, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxxx, ngjyra e xxxx, me traga **xx xxxx x.**
  - c- Mjetin e markës DAIMLER CHRYSLER, lloji autoveturë, tipi xxxxxx XXXXX Avangarde, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxxx, ngjyra xxx me traga **xx xxxx x.**
  - d- Mjetin e markës CHRYSLER, lloji autoveturë, tipi XXX XXXX XX XXXXX XX, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxxx, ngjyra xxx me traga **XX xxxx X.**
  - e- Llogarinë bankare në Raiffesen Bank me nr. xxxxxxxxxxx në emër të Shoqërisë « K. »sh.p.k., në shumën **47,112.17** lekë.
- **Për ekzekutimin** e këtij vendimi të ngarkohen Zyrat e Përmbartimit të

**Rretheve Tiranë dhe Vlorë, ndërsa për Administrimin dhe përdorimin** e pasurive **Z. K. Xh.**, i cili është Administrator në Agjensinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

- Urdhërohet sekretaria gjyqësore e kësaj gjykate të dërgojë menjëherë kopje të këtij vendimi në institucionet e mësipërme si dhe për njoftimin e zotëruesve të pasurive « K. » sh.p.k. në adresat e banimit, ose të qendrës së tyre.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda brenda afatit ligjor.

**U shpall sot në Tiranë, më datë 28/01/2012, ora 12.00.**

**Sekretare**  
**Ermira Tërbuni**

**Gjyqtare**  
**Iliriana OLLDASHI**

